



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHEJTI I GJYQËSOR I KOSOVËS - СУДСКИ САВЕТ КОСОВА - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE • ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.353/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Violeta Husaj Rugova kryesuese, Hajriz Hoti dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik, Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.02.2025, merr këtë:

V E N D I M

- I. PRANOHET** e bazuar ankesa e paraqitur nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Anr.353/2025 e datës 04.02.2025,
- II.** Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, i shqiptohet dënimi me gjobë në lartësi prej 4500 (katërmijë e pesëqind) euro, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatës fushatë zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Kosovës, që do të mbahen më datë 09.02.2025.
- III.** Detyrohet Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datën 04.02.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, në të cilën pretendohet se subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në rrjetin social facebook në profilin zyrtar, me datë 03 shkurt 2025, ka publikuar një fotografi për investimet e bëra në Klinikën e Oftalmologjisë, në të cilën fotografi e ka bashkangjitur edhe logon e subjektit politik LVV, fotografi e cila është realizuar në Institucionet publike shtetërore, me qëllim të përfitimit të votave. Andaj me këto

veprime subjekti politik LVV, i ka konsumuar te gjitha elementet e veprimit te përcaktuar me nenin 36, par.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme ne Republikën e Kosovës. Me tutje ne ankesë pretendohet se subjekti politik LVV, postimin e publikuar ne rrjetin social të realizuar ne ambientet e Klinikës se Oftalmologjisë e kane bere me qellim të promovimit te subjektit LVV dhe me qellim të përfitimit të votave për zgjedhjet e datës 09 Shkurt 2025.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur: Screenshot e postimit të publikuar nga profili zyrtar i Lëvizjes Vetëvendosje në rrjetin social Facebook dhe linkun https://www.facebook.com/story.php?story_fbid=1033901418776108&id=100064687781495&mibextid=wwXlfr&rdid=csFacDgUQBarwvmL#;

Më datë 04.02.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Levizja Vetëvendosje (LVV), për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri me datë 05.02.2025 në ora 11:00.

Në përgjigjen në ankesë të datës 05.02.2025, subjekti politik LVV, e kundërshton pretendimin e subjektit politik PDK, me arsyetimin se edhe pse pretendohet se LVV, ka shfrytëzuar hapësirat publike, konkretisht Klinikën e Oftalmologjisë pranë QKUK-së, në Prishtinë, për qëllim të fushatës zgjedhore siç ligji e ndalon në bazë të nenit 36 par 1, i cili nen parasheh se: Veprimet e ndaluara nga nëpunësit publik ashtu që “ Personi që mban pozitë publike, i zgjedhur apo i caktuar, nuk mund të përdorë atë zyrë ose ndonjë nga pasuritë e saj me qëllim të përfitimit te votave. Asnjë nga burimet e asnjë institucioni të administratës publike, qoftë të nivelit qendror ose lokal, ose edhe ndonjë ndërmarrje në zotërim ose të kontrolluar nga autoritete qendrore ose lokale, nuk mund të shfrytëzohen ose të futen në mbështetje të ndonjë subjekti politik në zgjedhje”. Me tutje në përgjigje në ankesë theksojnë se kanë të bëjnë me një interpretim të gabuar të pjesës materiale të ligjit nga ana e ankuesit, dhe se ligji në asnjë moment nuk i sanksionon përhapjen e pamjeve të një spitali në të cilin është investuar nga kjo qeveri dhe autorizimeve publike në ekzekutiv që ka, në bazë të Kushtetutës së Republikës së Kosovës përkatësisht në bazë të nenit 92 par.2 dhe 93 pika 11. Edhe pse është fakt notar se LVV ka qenë në pushtet legjislativ e kaluar, dhe e bëjnë direkt përgjegjëse për të gjitha punët ekzekutive dhe jo vetëm për zhvillimet në Klinikë për të cilat qeveria si organ ekziston. Po ashtu në përgjigje në ankesë theksojnë se nga pamjet e bashkangjitura nuk shihet se në kohë reale po bëhet fushat, por vetëm paraqitet gjendja dhe transformimi që ka ndodhur ne Klinik nga Ministria e Shëndetësisë, Ministri e cila është udhëhequr nga LVV gjate riparimit të saj. Andaj konsiderojmë se është në përputhje me qëllimin e vet Fushatës që garanton avokimin e subjekteve politike për premtimet dhe të arriturat e tyre, e cila garantohet edhe me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë.

Ne përgjigje në ankesë theksojnë se në asnjë moment norma 36 e Ligjit për Zgjedhjet nuk e sanksionon përdorimin e pamjeve nga e kaluara për qëllim të promovimit dhe avokimit në fushatë zgjedhor, por e ndalon përdorimin e këtyre hapësirave për fushatë zgjedhore, andaj konsiderojmë se një interpretim gramatikë i normës do të ishte më lehtë te bazohet saktë dhe drejt në normën subjekti ankues që ka iniciuar procedurën për në PZAP.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

Ankesa është bazuar

Paneli, ka vlerësuar ankesën dhe përgjigjen në ankesë ka gjetur se postimi i fotografisë për investimet e bëra në Klinikën e Oftalmologjisë të cilës i kanë bashkangjitur logon e subjektit politik LVV, dhe linkut të ofruara si provë materiale, në ankesë të Subjektit Politik, Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dhe shkresave tjera të lëndës, ka vlerësuar se nga ana e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), është shkelur Rregullorja Zgjedhore Nr. 07/2024 për Fushatën e Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, pasi që subjekti në fjalë, me qëllim të promovimit të subjektit të tyre politik dhe përfitimit të votave, gjatë fushatës zgjedhore në rrjetin social facebook në profilin zyrtar, me datë 03 shkurt 2025, ka publikuar një fotografi për investimet e bëra në Klinikën e Oftalmologjisë, në të cilën fotografi e ka bashkangjitur edhe logon e subjektit politik LVV, pra fotografi e cila është realizuar në Institucionet publike shtetërore, veprim ky i cili bie në kundërshtim me dispozitën e nenit 36 par. 2, Ligji Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës parashihet se: “Gjatë fushatës zgjedhore asnjë subjekt politik nuk inkurajon ose përfiton nga nëpunësi publik duke përdorur pozitën publike të tij ose saj për të zhvilluar fushatë për subjektin politik”, ndërsa me paragrafin 3 parashihet që: *Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të subjekteve politike në zgjedhje, burime ose resurse të institucioneve apo organeve publike në nivel qendror ose lokal, apo çdo lloj institucioni tjetër publik.*

Paneli e shqyrtoj përgjigjet në ankesë nga subjekti politik LVV dhe vlerësoi se pavarësisht se bëhet fjalë për fotografi, me dispozitat ligjore nuk lejohet mundësia e bërjes së fushatave duke përdorur institucione publike apo resurset e tyre. Andaj pretendimet në përgjigje në ankesë janë të pa bazuara.

Paneli me rastin e vendosjes së gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, se ky veprim i tyre përben përsëritje të shkeljes së legjislacionit zgjedhor. Kjo konsiston në faktin se Subjekti Politik LVV, ka qenë i njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës zgjedhore. Andaj përfshirja për fushatë zgjedhore ambientet e institucionit duke teguar investimet e bëra, në këtë rast të Klinikës së Oftalmologjisë, përben shkelje të legjislacionit zgjedhor, saktësisht e sanksionuar me dispozitën e lartcekur të rregullës zgjedhore.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 36 paragrafi 1, neni 118 paragrafi 1, neni 120 paragraf 1 nën paragrafi 1.3, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.353/2025 më datë 06.02.2025

Kryesuese e Panelit
Violeta Husaj Rugova



Këshilla Juridike: *Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.*